



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2023

***PËR MIRATIMIN E RITJES TË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E
GRANTIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “PËRFSHIRJE SOCIALE PËR
NDRYSHIM” MIDIS BASHKISË KORÇË DHE PROGRAMIT TË KOMBEVE TË
BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP)***

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social.
Duke iu referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, ligjit nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 19.1.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë”, urdhrin nr. 14 datë 10.1.2023 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2023 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe produkteve, si dhe marrëveshjes së Bashkëpunimit me Nr. 4818 Prot., datë 21.06.2023 midis Bashkisë Korçë dhe Programit Të Kombeve Të Bashkuara Për Zhvillim dhe sipas propozimit të Drejtorisë së Kujdesit Social :

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

- 1- Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave dhe përdorimin e grantit me vlerën 1,800,000 lekë për realizimin e projektit “ Përfshirje sociale për ndryshim”***
- 2- Të miratojë përdorimin e grantit si më poshtë dhe me këtë strukturë :***
 - Krijimi i rrjetit lokal të palëve të interesuara me vlerë totale 400,000 lekë***
 - Inicimi i një shërbimi të lëvizshëm për informimin dhe identifikimin e nevojave me***

vlerë totale 700,000 lekë

- Trajnime për nënat dhe fëmijët me vlerë 350,000 lekë

-Trajnim profesional për të rinjtë dhe për orientimin drejt kërkesave të tregut me vlerë 350,000 lekë

Programi Përkujdesi Social

SHTOHET AII22 Prod. V043AAI 00 Art. 6020000 05 +1,800,000 lekë

3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social; Drejtoria e Prokurimeve Publike; Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK.

4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

KRYETARE

Ana Verushi

Miraturar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____